



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 389/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës - Blerim Grainca nga subjektit politik Lidhja Demokratike Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja më datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës – Blerim Grainca nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 26.06.2014, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës- Blerim Grainca të subjektit politik LDK me nr.76 në Ferizaj, me të cilën pretendohet se gjatë numërimit kanë konstatuar se ka fituar vota, por votat e fituara nuk ju kanë shënuar fare në FRK. Pretenduesi i ankesës thekson se ky gabim ka ndodhë në QV. 2509D, VV. 03R dhe kërkon që ky gabim të përmirësohet dhe votat e tij ti llogariten edhe në rezultatin final të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmisë ka ofruar deklaratën e anëtarit të komisionit në VV 2509D/03R- Nazif Mjaku dhe kopjen e FRK-së.

Në nenin 117. 2 të LZP-së është paraparë : *“Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme.”* Andaj në pajtim me këtë dispozitë juridike, PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i. ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati për deputet-Blerim Grainca me nr. 76 të subjektit politik LDK në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij, ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të materialit zgjedhor në QNR, për votat për të cilat pretendon në ankesë se i mungojnë votat e fituara në vendvotimin 2509D/03R.

Nga ekipi hetues i PZAP-it është hapur kutia e votimit me numër 2509/03R për Komunën e Ferizajt e cila kuti ka qenë e mbyllur prej 4 shiritave anësorë të sigurisë dhe një shirit në mes të kutisë. Shiritat anësor të sigurisë kanë numrin 113757, 113756, 113758 dhe 100700, ndërsa shiriti i mesëm me numër 113755 nuk është prekur fare. Shiriti i thesit brenda kutisë së votimit kishte numrin 113759. Po ashtu konstatohet mbyllja e thesit brenda kutisë me shirit të sigurisë me numër 0010386 dhe mbyllja kutisë së votimit me shiritat të sigurisë me numra 056539, 076964, 056538 dhe 026476, ndërsa shiriti i mesëm nuk është prekur fare prandaj edhe ka mbetur i njëjti.

PZAP-it ka konstatuar nga origjinali i Formularit të Përputhjes së Rezultateve (FRK), që gjendet në QNR, se kandidati me nr. 76 nga radhët e subjektit politik LDK, i posedon 54 vota e jo siç ka pretenduar në ankesën e tij se nuk e posedon asnjë votë apo nuk janë shënuar këto vota në FRK.

Për më tepër ekipi hetues i PZAP-it, e ka hapur kutin e votimit 2509D/03R, dhe i ka numëruar të gjitha fletëvotimet e kandidatit në fjalë dhe pas numërimit të votave rezultojnë se i njëjti posedon 54 vota siç edhe kanë qenë në FRK origjinal në QNR dhe poashtu të njëjtat vota janë të përfshira në rezultatin përfundimtar për kandidatin nr.76 nga radhët e subjektit politik LDK.

Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 389/2014 më datën 30.06.2014

Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani



Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*